

## Plani i Mobilitetit

### Çfarë është Plani i Mobilitetit?

Plani i Mobilitetit është një akt juridik që përcakton detyrimet dhe të drejtat e dy Universiteteve kur zbatojnë një Projekt Shkëmbimi Afatshkurtër për Stafin Akademik.

Nëse Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, përfshihet në një Projekt Shkëmbimi Afatshkurtër për Stafin Akademik me një Universitet të Huaj dhe shpall thirrjen për këtë projekt, atëherë çdo anëtar i stafit akademik gjatë aplikimit në këtë thirrje duhet të dorëzojë dokumentet që pasqyrohen në thirrje si edhe të plotësojë Planin e Mobilitetit.

Më poshtë gjeni udhëzimet përkatëse për çdo tabelë në Planin e Mobilitetit.

Në krye të Planit të Mobilitetit çdo anëtar i stafit akademik të shfaqë kohëzgjatjen e plotë të shkëmbimit {ditën, muajin, viti i fillimit dhe mbarimit të periudhës së shkëmbimit; ditët e qëndrimit pa llogaritur brenda tyre ditët e udhëtimit}

### Udhëzimet për tabelën numër 1

#### The teaching staff member- Anëtar i Stafit të mësimdhënies

Last name (s)		First name (s)	
Seniority <sup>i</sup>		Nationality <sup>ii</sup>	
Sex [M/F]		Academic year	20../20..
E-mail			

Në këtë tabelë ju duhet të paraqisni të dhënat tuaja personale, të cilat sipas renditjes së tabelës janë:

- Mbiemri
- Emri
- Vjetërsia në Punë
- Kombësia
- Gjinia
- Viti akademik
- Adresa e postës elektronike

**Shënim-** Zëri “ Seniority” ose “ Vjetërsia” në punë ndahet si më poshtë:

**Junior** – më pak se 10 vite përvojë pune

**Intermediate-** më shumë se 10 vite dhe më pak se 20 vite përvojë pune

**Senior-** 20 apo më shumë vite përvojë pune.

## Udhëzimet për tabelën numër 2

### **The Sending Institution/Enterprise<sup>iii</sup>- Institucioni dërgues/ ndërmarrja**

Name			
Erasmus code <sup>iv</sup> (if applicable)		Faculty/Department	
Address		Country/ Country code <sup>v</sup>	
Contact person name and position		Contact person e-mail / phone	
Type of enterprise: NACE code <sup>vi</sup> (if applicable)		Size of enterprise (if applicable)	<input type="checkbox"/> <250 employees <input type="checkbox"/> >250 employees

Në këtë tabelë ju duhet të paraqisni të dhënat që kanë të bëjnë me institucionin dërgues ( Universitetin e Mjekësisë), të cilat sipas renditjes së tabelës janë:

- Kodi institucional i Erasmus + { Vetëm Universitetet që i përkasin vendeve të BE-së apo Universitetet që janë pjesë e Programit kanë një kod të tillë; në rastin e UMT-së kjo e dhënë plotësohet përmes një vize {-}.
- Fakulteti apo departamenti në të cilin zhvillon aktivitetin tuaj akademik.
- Emrin e Koordinatorit Akademik në nivel Fakulteti
- Adresën e postës elektronike dhe numrin e telefonit të Koordinatorit Akademik

Shënim- Koordinatorët Akademik në nivel fakulteti për Universitetin e Mjekësisë janë:

- Dr.Shk. Durim Çela për Fakultetin e Mjekësisë
- Prof.Virgjini Mulo për Fakultetin e Mjekësisë Dentare
- Prof.Ass. Vjollca Shpata për Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike

### Udhëzimet për tabelën numër 3

#### The Receiving Institution- Institucioni Pritës

Name		Faculty/Department	
Erasmus code (if applicable)			
Address		Country/ Country code	
Contact person name and position		Contact person e-mail / phone	

Kjo tabelë duhet të plotësohet nga përfaqësuesi i Institucionit Pritës, i cili në këtë rast është Universiteti i Huaj, me të cilin Universiteti i Mjekësisë zbaton projektin e shkëmbimit.

### Section to be completed BEFORE THE MOBILITY

### Rubrika që duhet plotësuar para periudhës së shkëmbimit

Në krye të kësaj Rubrike anëtari i stafit akademik duhet të paraqesë të dhëna mbi periudhën e shkëmbimit, të cilat sipas renditjes në Planin e Mobilitetit janë si vijon:

- Fusha e mësimdhënies
- Cikli i studimit
- Numri i studentëve në Institucionin Pritës ( Universitetin e Huaj) të cilëve anëtari i stafit akademik nga UMT-ëja do t'u jape mësim.
- Numri i orëve të mësimdhënies
- Gjuha e mësimdhënies

**Overall objectives of the mobility:Objektivat e përgjithshme të shkëmbimit**

Në këtë zë anëtari i stafit akademik nga UMT-ëja duhet të përshkruajë objektivat kryesore që do të përmbushë përmes periudhës së shkëmbimit në Universitetin e Huaj.

**Added value of the mobility (in the context of the modernisation and internationalisation strategies of the institutions involved):- Rëndësia e këtij shkëmbimi në kontekstin e modernizimit dhe ndërkombëtarizimit të institucioneve që përfshihen në projekt)**

Në këtë zë anëtari i stafit akademik nga UMT-ëja duhet të përshkruajë dobinë që ka kjo periudhë shkëmbimi në kontekstin e modernizimit dhe ndërkombëtarizimit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

**Content of the teaching programme:- Përmbajtja e Programit mësimor**

Në këtë zë anëtari i stafit akademik nga UMT-ëja duhet të paraqesë përmbajtjen e programit mësimor që do të zhvillojë në Universitetin e Huaj.

**Expected outcomes and impact (e.g. on the professional development of the teaching staff member and on the competences of students at both institutions): Ndikimi që do të ketë kjo periudhë shkëmbimi në rritjen**

### **profesionale të stafit akademik dhe tek studentët e dy institucioneve**

Në këtë zë anëtari i Stafit Akademik pranë UMT-ëse duhet të pasqyrojë ndikimin që ai mendon se do të ketë kjo periudhë shkëmbimi në rritjen e tij profesionale dhe gjithashtu tek studentët e Universitetit të Huaj dhe studentët e Universitetit të Mjekësisë.

### **COMMITMENT OF THE THREE PARTIES**

#### **Zotimi i tri palëve**

Në këtë Rubrikë anëtari i stafit akademik të Universitetit të Mjekësisë, Koordinatori Institucional në nivel Rektorati në UMT si dhe përfaqësuesi i Universitetit të Huaj, miratojnë planin e mobilitetit.

Në zërat që përbëjnë këtë rubrikë duhet të firmosin

- Anëtari i Stafit Akademik
- Koordinatori Institucional në Universitetin e Mjekësisë Prof. Alma Idrizi
- Koordinatorin Institucional në Universitetin e Huaj

#### **The teaching staff member**

Name:

Signature:

Date:

#### **The sending institution/enterprise**

Name of the responsible person:

Signature:

Date:

#### **The receiving institution**

Name of the responsible person:

Signature:

Date:

**Shënim-** Plani i Mobilitetit plotësohet gjithmonë në bashkëpunim me Koordinatorin Akademik të Universitetit të Huaj lidhur me kohën kur do të kryeni periudhën e shkëmbimit.

Kontaktet e Koordinatorit përcillen gjithmonë nga Universiteti i Huaj.

Kontakti i Koordinatorit të Universitetit të Akuilës është:

***Medicine, biology, environmental sciences***

***Prof. Maria Adelaide Continenza – [mariaadelaide.continenza@cc.univaq.it](mailto:mariaadelaide.continenza@cc.univaq.it)***

---